



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:130390

Datë: 30.06.2024

Numri i dokumentit: 05876824

KPPP.nr.1529/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Natyra Dea” SH.P.K., me seli në rr. “Dëshmorët e Gollakut”, në Fshatin Hajvali, në Prishtinë, me NUI: 810815821, kundër debitorit The North Unicorn L.L.C., me NUI: 810112186, me seli në rr. “Zona Industriale”, në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqësojnë Arianit Koci dhe Granit Vokshi, avokatë nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.240/22 të datës 27.05.2022, të Përmbartuesit Privat Destan Bujupaj me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 28.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit The North Unicorn L.L.C., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.240/22 të datës 27.05.2022, të Përmbartuesit Privat Destan Bujupaj.
- II. MBETET në fuqi Urdhri Përmbartimor P.nr.240/22 i datës 27.05.2022 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Destan Bujupaj.
- III. URDHËROHET debitori “The North Unicorn L.L.C., që në rast të parashtrimit ankesës, të deponoj në llogari të veçantë të “Këshillit Gjyqësor të Kosovës”, nëpërmjet arkës së Gjykatës Themelore në Prishtinë, garancionin në shumën prej 13,861.30 €, (trembëdhjetë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e një euro e tridhjetë cent), në afat prej 7 (shtatë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.

IV. Nëse debitori nuk e deponon garancionin brenda afatit të caktuar, ankesa e ushtruar kundër këtij aktvendimi, do të konsiderohet se nuk është dorëzuar fare nga pala ankuese.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të autorizuarit të kreditorit “Natyra Dea” SH.P.K., ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.240/22 të datës 27.05.2022, me të cilin ka lejuar përmbartimin, në bazë të dokumentit të besueshëm: Faturës Nr. 110220037 të datës 02.11.2020; Faturës Nr. 020921015 të datës 09.02.2021; Faturës Nr. 121720008 të datës 17.12.2020; Faturës Nr. 113020006 të datës 30.11.2020; Faturës Nr. 062220007 të datës 22.06.2020; Faturës Nr. 011221022 të datës 12.01.2021; Faturës Nr. 031821020 të datës 24.03.2021; Faturës Nr. 033121022 të datës 31.03.2021; Faturës Nr. 040921022 të datës 09.04.2021; Faturës Nr. 042121005 të datës 27.04.2021; Faturës Nr. 052621016 të datës 26.05.2021; Faturës Nr. 060321017 të datës 03.06.2021; Faturës Nr. 070521004 të datës 05.07.2021 dhe Faturës Nr. 101921020 të datës 19.10.2021, me të cilën është obliguar debitori që në afat prej 7 ditëve nga pranimi i urdhrin të përmbush detyrimin në shumën e mbetur prej 13,861.30 €, me kamatë ligjore prej 8%, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore, nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm dhe pasojave tjera ligjore, ashtuqë përmbushja e detyrimeve të debitorit të realizohet me bllokimin e të gjitha llogarive bankare të debitorit, si dhe me sekuestrimin, vlerësimin dhe shënimin e përmbartimit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesve të autorizuar, ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor, duke theksuar ndër të tjerash se tetë nga pesëmbëdhjetë faturat e paraqitura në propozim nuk përmbajnë nënshkrimin, si dhe vulën e personit të autorizuar. Më tutje ka shtuar se me kreditorin kanë pasur marrëveshje për shitblerje të artikujve ushqimor dhe se ka qenë gjithmonë korrekt ndaj kreditorit duke kryer gjithnjë pagesa, me çka tregon përmbushje të vazhdueshme vullnetare të detyrimit sipas faturave të cilat kanë qenë të pranuar në mënyrë të rregullt dhe i kanë përmbushur kushtet ligjore. Gjykatës i ka propozuar që të aprovohet në tërësi prapësimi i debitorit, të shfuqizohet urdhri përmbartimor, si dhe të obligohet pala kreditore që t’i paguaj shpenzimet përmbartimore, përkatësisht shpenzimet për përpilimin e prapësimit në vlerën prej 208.00 €, sipas tarifës së Odës së Avokatëve.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit, duke deklaruar se faturat e bashkëngjitura janë të nënshkruara dhe të vulosura nga ana e debitorit dhe të njëjtat janë të deklaruara edhe pranë Administratës Tatimore të Kosovës. Në lidhje me pretendimet e debitorit rreth kontestimit të borxhit, ka theksuar se debitori ka paraqitur transaksione bankare në vlerën totale prej 1,500.00 €, ndërsa nuk ka argumentuar të njëjtat, pasi që vlera e faturave është shumë më e madhe dhe pagesat e kryera janë minimale, krahasuar me vlerën totale të obligimit. Në fund ka bashkëngjitur edhe kartelën financiare lidhur me transaksionet në mes të debitorit dhe kreditorit, si dhe vlerën totale të borxhit. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi i debitorit, si dhe të aprovohet në tërësi si i themeltë urdhri përmbarimor.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjen në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbarim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara dhe janë të përshtatshme për përmbarim, bazuar në dispozitat e nenit 29 par.3 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*. Me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm - Faturën Nr. 110220037 të datës 02.11.2020; Faturën Nr. 020921015 të datës

09.02.2021; Faturën Nr. 121720008 të datës 17.12.2020; Faturën Nr. 113020006 të datës 30.11.2020; Faturën Nr. 062220007 të datës 22.06.2020; Faturën Nr. 011221022 të datës 12.01.2021; Faturën Nr. 031821020 të datës 24.03.2021; Faturën Nr. 033121022 të datës 31.03.2021; Faturën Nr. 040921022 të datës 09.04.2021; Faturën Nr. 042121005 të datës 27.04.2021; Faturën Nr. 052621016 të datës 26.05.2021; Faturën Nr. 060321017 të datës 03.06.2021; Faturën Nr. 070521004 të datës 05.07.2021 dhe Faturën Nr. 101921020 të datës 19.10.2021, e të cilat i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara mallrat të cilat kanë qenë objekt i këtyre faturave është përcaktuar shuma e cila përben detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat e lartcekura i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP, për zbatimin e përmbartimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që të njëjtat janë dorëzuar në origjinal, mbajnë vulën dhe nënshkrimin e pranimit të debitorit në dëftesat për pranimin e mallrave, si dhe nuk janë kontestuar asnjëherë nga debitori.

Gjykata vlerësoi pretendimin e debitorit, se në rastin konkret ka paguar disa detyrime sipas faturave kontestuese, mirëpo gjeti se një pretendim i tillë është i pa bazuar, për faktin se debitori nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi përmes së cilës do të mund të vërtetohej një fakt i tillë, meqenëse nga fletëpagesat e dorëzuara, nuk rezulton se borxhi i paguar ka të bëjë me faturat kontestuese për të cilat është iniciuar propozimi për përmbartim.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera të debitorit, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i procedurës përmbartimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të formalitetit rigoroz, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbartimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit si objekt përmbartimi.

Në pikën III të dispozitivit të këtij aktvendimi, gjykata ka urdhëruar debitorin që në rast të parashtrimit të ankesë kundër këtij aktvendimi, të deponoj garancinë në gjykatë, në shumën e përcaktuar si në këtë pikë të dispozitivit të këtij aktvendimi dhe gjykatës t'ia dorëzoj provën për pagesën e garancionit, konform dispozitës ligjore të nenit 78 par.2 dhe 4 të LPP-së.

Andaj bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1529/23, datë 28.06.2024

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.